



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA		QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA		MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org:		Nr.Prot:			
Org.Jedësia:	01	Brei Prot:	05-10072		
Org Unit:		Prot.No:			
Nr.i faqëve:	-70-	Data:			
Br.stranica:		Datum:	23, 12, 20	24	
No.pagus:		Date:			
Prishtinë / a					

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit- Ured Ministra -Office of the Minister

Nr:208/XII/2024

Datë:23.12.2024

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 11 paragrafi 1.5 i Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca 1 paragrafi 6 nënparagrafi 6.1, si dhe bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale lidhur me propozimin me nr. prot. 05-9178 datë 25.11.2024 të Komisionit për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale të deklaruara nga Bartësit e autorizim marketingut në Kosovë apo përfaqësuesit e autorizuar të Bartësit të autorizim marketingut.
- II. Lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale nga pika I e këtij vendimi hyn në fuqi prej muajit shkurt (datë 01.02.2025) dhe vlen një vit nga data e hyrjes në fuqi.
- III. Përjashtimisht nga pika I e këtij vendimi ndryshimi i çmimeve të produkteve medicinale bëhet sipas vendimit të ministrit me të cilin përcaktohet afati për ndryshim të cmimit;
- IV. Për produktet medicinale për të cilat Bartësit e autorizim marketingut apo përfaqësuesit e autorizuar të Bartësit e autorizim marketingut kanë regjistruar produktet medicinale në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) pas datës 4 prill 2024 qarkullojnë në Kosovë deri në nxerrjen e një vendimi tjetër;
- V. Për produktet medicinale të cilat qarkullojnë pa Autorizim marketing dhe autorizim të kufizuar, procedura e deklarimit të cmimit bëhet sipas Vendimit të Komisionit për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale.

- VI. Obligohen qarkulluesit me pakicë - barnatoret të vendosin çmimin sipas Listës zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale në të gjitha produktet që ka në gjendje.
- VII. Obligohet AKPPM të ndermerr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi;
- VIII. Lista zyrtare e çmimeve të produkteve medicinale është pjesë e këtij vendimi dhe e njejta do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Agjencisë së Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale.
- IX. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m i

Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i ankesave për çmimin e produkteve medicinale dhe referuar shkresës me nr. prot. 05-9178, datë 25.11.2024 nga Komisioni për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale për Listen finale të çmimeve të produkteve medicinale, bazuar në dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-220 për çmimin e produkteve medicinale, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Dr. Arben Vitia

Ministër i Shëndetësisë


Vendim i dërgohet:

- Zëvendësministrave të MSH-së;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Ud Kryeshefit të AKPPM-së;
- Znj. Virtyte Krasniqi, Kryesuese e Komisionit;
- Departamentit ligjor;
- Arkivit të MSh-së.